

INTERVISTË ME NIKOLLA BRKIQIN

Janjevë | Data: 21 gusht, 2019

Kohëzgjatja: 52 minuta

Të pranishëm:

1. Nikolla Brkiq (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: A mund të prezantoheni?

Nikolla Brkiq: Unë jam Nikolla Brkiq, i lindur në Janjevë. Gjyshi im, stërgjyshi im katragjyshi im, tonët janë 700 vjet këtu kanë ardhur nga Dubrovniku dhe Konavle, nga Kroacia. Janjeva është diaspora më e vjetër kroate. Dhe tonët brez pas brezi kanë jetuar këtu, kanë punuar, jetuar, janë shkolluar dhe kështu me radhë.

Anita Susuri: A mund të më flisni pak për familjen tuaj, për babain tuaj, gjyshin?

Nikolla Brkiq: Po gjyshi ka qenë varfanjak e ka pasur një vëlla. Ata në atë kohë kanë qenë tregtarë, vëllaun e ka pasur tregtar, e gjyshi është marr me bujqësi. Gjyshi im i ka pasur dhjetë fëmijë, katër djem dhe gjashtë vajza. Falë Zotit, të gjithë janë tani, dua të them disa kanë vdekur por kanë mbetur pasardhësit, pra kanë fëmijë, nipër, stërnipër. Dhe kjo është një pasuri e madhe për fenë tonë romako-katolike në Janjevë që ne kroatët i takojmë, jemi romako-katolikë.

Anita Susuri: Me çka është marr gjyshi juaj?

Nikolla Brkiq: Gjyshi jonë kryesisht është marr me bujqësi. Bashkë me gjyshen kanë pasur shumë tokë, kanë blerë toka, bagëti, një djal ka qenë vozitës, xhaxhai i gjyshit. Tjetri ka qenë invalid i ushtrisë, është lënduar në ushtri e babai ka qenë bujk.

Anita Susuri: Këtu në Janjevë do të thotë më shumë janë marr me metal dhe me përpunimin e metalit, e familja juaj është marr me bujqësi. Si dhe pse?

Nikolla Brkiq: Po Janjeva është një vend specifik në botë që ka qenë dhe ka mbetur, por tani është pikëlluese që diçka po shpëputet, shpërngulje ka pasur shumë, shumë njerëz janë shpërngulur. Ata fillimisht kanë ardhur si minatorë, përpunues të monedhave, monedhave të arit. Edhe ata atëherë

kanë gërmuar minerale, kanë punuar për Republikën e Dubrovnikut dhe kështu mendoj. Këta kanë qenë paraardhësit tonë, dua të them pastaj kanë qenë prej vitit 303 [1303]. Kisha i është dedikuar Shën Kollit në Janjevë pastaj kanë filluar janë marr edhe me vreshtari, pastaj disa janë marr me bagëti, disa kanë qenë tregtarë. Shkonin, tregtonin por kryesisht kanë ardhur për shkak të mineraleve dhe kanë nxjerrë minerale, kanë prodhuar monedha.

Anita Susuri: E familja juaj është marr me bujqësi? Do të thotë, juve ju kujtohet gjyshi juaj që ka filluar apo dikush edhe më tutje?

Nikolla Brkiq: Po kanë punuar edhe më tutje kanë punuar. Ne përndryshe, tani kemi qenë tregtar, dua të them kemi punuar dhe punojmë në Kroaci, vëllezërit dhe djemtë e xhaxhait, djemtë e hallave edhe ata janë tregtarë. Kurse ne kemi mbetur me bujqësi. Dua të them unë kam mbetur me bujqësi.

Anita Susuri: A ju kujtohet fëmijëria juaj? Mendoj, me siguri ju kujtohet, por çfarë ju ka mbetur më shumë...?

Nikolla Brkiq: Po më shumë më ka mbetur, kemi qenë pesë mijë njerëz, kemi qenë, kjo është vatra e gjyshit tim Kërstes. Kjo shtëpia është ndërtuar në vitin 1952. Këtu jemi mbledhur nga 50 fëmijë të djelën mbrëma, vinin hallat, fëmijët e hallave dhe kështu. Mblidheshim, luanim fshehurazi, atëherë nuk ka pasur telefon, nuk ka pasur televizor, vonë ka ardhur. Luanim fshehurazi, atë që ne e quajmë karabinjerët, luanim maska të Klisit siç e quajmë. Kështu ka qenë. Shkonim në shkollë, atëherë ka qenë tjetër kohë, mësimdhënësit kanë qenë të rreptë, është dashur t'i bësh detyrat e shtëpisë, të mësosh. Shkonim në mësimin fetar dy herë në javë.

Në kishë për çdo festë kemi shkuar, dua të them edhe për çdo festë dhe të djelën ka qenë e domosdoshme ajo, ndaheshim dikush në mëngjes, dikush në mesditë, dikush në mbrëmje [shkonin në kishë]. Edhe nëna edhe babai, të gjithë, duhej të shkonim në kishë, t'i lutemi Zotit dhe kështu. Gjithmonë kur ka ndonjë gëzim, kur hamë, drekojmë apo diçka, nëna gjithmonë është lutur, "Ati ynë" pastaj fillonim të hanim, pastaj e falënderonim Zotin. Dua të them e falënderonim të gjithëmundshmin Zot, për të gjitha të mirat që na i ka dhënë, për bukën dhe këto, kështu ka qenë gjithmonë.

Ka pasur gjëra të bukura si fëmijë, kanë qenë këtu, secila shtëpi i ka pasur shtatë, tetë, nëntë fëmijë. E për Krishtlindje kur shkonim, kur ka qenë, në gjashtë ora ka qenë mesha e mëngjesit, ajo quhet mëngjesore. Atëherë shkonim, prej shtëpisë në shtëpi, dikush flente, këmbana e madhe binte ne shkonim e thërrisnim, e zgjonim. Pastaj ka pasur gara, një pjesë e Janjevës, pjesa e dytë e Janjevës, pjesa e tretë e Janjevës, kush më shumë shkon në mëngjesore dhe atëherë ata, ajo rrugë fiton, ajo pjesë e Janjevës e fiton falënderimin.

Anita Susuri: Si është sjell babai juaj me juve?

Nikolla Brkiq: Babai ka qenë zot shtëpie. Punëtor i madh, që themi ne me pagë ditore dhe me pak tokë që kemi pasur jemi ushqyer, dhjetë fëmijë. Të gjithë jemi të shkolluar, kemi shkuar në shkollë deri në klasën e tetë, disa pastaj kanë vazhduar në shkollë të mesme. Vonë por... kështu kanë qenë kohërat, atëherë ka pasur varfëri në Janjevë. Kanë qenë shtëpitë e vjetra, nuk ka pasur kushte, pa ujë, pa këto. Ne fatmirësisht kemi pasur bunar, kanë pasur njerëzit kur jemi zhvendosur, prej burimit, me shishe ujin, prisnin nga një orë për ta mbushur.

Anita Susuri: A ka qenë jeta e vështirë për gratë? Për shembull, për nënën tuaj, si e kujtoni ju atë?

Nikolla Brkiq: Po jeta e gjyshes sime ka qenë shumë e vështirë mendoj, por atëherë njerëzit kanë qenë punëtor, njerëz të shëndoshë dhe të fortë. Gjyshin tim shpesh e kanë thirrë në ushtrime ushtarake e gjyshja ime është kujdesur edhe për fëmijët edhe bagëtinë edhe në ara shkonte për të lëvruar, për të mbjellë madje punonte “me gomë” që thuhet, me duaj¹, meqë e kanë përpunuar grurin që të jetojnë. Jeta ka qenë e vështirë atëherë. Nëna, dhjetë fëmijë i ka lindur. Duhet t’i ushqesh, t’i mbështjellësh ata, atëherë nuk kanë qenë pelenat Pampers, por kanë qenë ato pelenat e thjeshta, ato të lahen, të teren. Fatmirësisht, pas vitit ‘74 e kemi blerë makinën e parë “Gorenje”, e kemi vendosur hidroforin. Ujin prej bunari dhe mendoj që ka qenë shumë më lehtë pastaj për të. Por vetëm të gatuash për dhjetë fëmijë është mjaft. Është jetuar mjaft vështirë.

Anita Susuri: Cilat tradita të tjera i keni pasur në familjen tuaj? Kur ju keni qenë më i vogël?

Nikolla Brkiq: Po nuk e di për cilat po mendoni...

Anita Susuri: Për shembull çka keni festuar, si keni festuar? Diçka lidhur me këtë.

Nikolla Brkiq: Aha, po ne, ne i kemi dy festa. Domethënë, festa e Shën Kollit është e jona, paraardhësit tonë e kanë festuar edhe në kohën e turqve, dua të them edhe më herët. Ai është mbrojtësi Shën Kolli, kisha e Shën Kollit dhe atë festën ne e festojmë. Atëherë, gjithmonë e bekojmë pogaqen dhe e thërrasim familjen për darkë në festë. Të nesërmen është dita e emrit tim dhe pastaj vijnë njerëzit. E kemi edhe festën e Shën Kollit, i kemi pasur këto. E kemi edhe Shën Sebastianin, mbrojtësin e shëndetit. Është Kisha në Peshter, shtatë-tetë kilometra prej këtu është në mal dhe atje ne shkojmë në këmbë për atë ditën 20 janarin kur i bie Shën Kolli dhe ne shkojmë në këmbë direkt lartë, nëpër borë, shi, borë, ftohtë, ne shkojmë në meshë lartë atje.

Edhe tani kjo vazhdonte sa ishin në Janjevë por tani vjen rinia nga Zagrebi, nga Shibeniku, nga Kroacia. Nga e gjithë Kroacia rinia vjen për atë ditën, shkojnë edhe në këmbë, të shumtë betohen që do të shkojnë në këmbë, dikush shkon edhe me veturë, shkojnë përreth. Dhe kryesisht, për meshën e shenjtë, në ora nëntë është mesha e shenjtë atë ditë, në Peshter.

¹ Grumbull i barit që është mbjellur dhe tharë.

Anita Susuri: A është edhe e juaja... Më falni.

Nikolla Brkiq: Ne shkojmë edhe në Letnicë gjithashtu, shkonim në këmbë. Mendoj që kjo është që nga krijimi i Janjevës. Shkohet në këmbë, prej tetë deri në dymbëdhjetë orë udhëtohet, nëpërmes malit. Fillojmë në mbrëmje në ora tetë pastaj në mëngjes nesër mbërrimë atje. Dymbëdhjetë orë në këmbë, shkohet për Zonjën e Madhe, për 1 maj dhe për Zonjën e Vogël më 8 shtator, e Zonja e Madhe është më 15 gusht.

Anita Susuri: A keni shkuar ju ndonjëherë ashtu në këmbë?

Nikolla Brkiq: Kam shkuar në vitin 1988.

Anita Susuri: Si ka qenë?

Nikolla Brkiq: Ne kemi shkuar, ne kemi qenë pesë veta ne kemi mbërritur për tetë orë e gjysmë në këmbë. Të gjithë kemi qenë me kondicion, meshkuj kemi qenë. Përndryshe, shkojnë edhe gratë edhe më të moshuarit, shkojnë edhe rinia. Ngadalë, ngadalë, kur të mbërrijnë, mbërrijnë por shkojnë. Kanë shkuar po ashtu edhe në Dunav në kishën e Shën Anës. Ajo është edhe më larg se Letnica, edhe dy-tri orë edhe atje poashtu shkohet. Shkohet për Shën Anën. Më herët shkonin shumë, tani disa shkojnë me veturë por ka që shkojnë diku dy-tre edhe pesë [persona] ndonjë vit, që shkojnë në Dunavë. Shkonim te Kisha e Shën Antonit në Prishtinë, shkohej poashtu, më datë 13 e marte shkohej dhe në ditën më 13 qershor i bie dita e Shën Antonit në Prishtinë. Është i katërti, dua të them e 14-ta ditë që shkohet në këmbë. Do të thotë, çdo të dielë shkohet në këmbë për në Prishtinë. Dhe atje qëndrojnë për meshë pastaj prej meshës dikush kthehej në këmbë, dikush me autobus. Nëse shkohej për ditën e Shën Antonit, më shumë është shkuar në këmbë edhe për atje edhe për këndej.

Anita Susuri: Pse shkohet në këmbë, a ka ndonjë [domethënje] diçka?

Nikolla Brkiq: Po ne jemi besimtar të mëdhenj dhe dua ta them këtë, shkohet edhe për shëndet edhe për fat, edhe për përparim dhe këto. Shkojmë, i lutemi Zotit, Shën Antonit, për shembull për Nënë e Perëndisë dhe Shën Anën dhe domethënë ata shenjëtorët që i kemi për momentin në Kosovë.

Anita Susuri: Veshja tradicionale atëherë është mbajtur në Janjevë. Çfarë përshtypje ju ka lënë juve atëherë?

Nikolla Brkiq: Po gjyshja ime gjithnjë ka bartur dimia, xhamadanin, ato këmishat dhe kjo ka qenë veshja. Si veshja turke, veshja prizrenase, diçka e tillë ka qenë. Paraardhëset tona, nënat, gjyshet domethënë i kanë bartur. Tani më ato, domethënë kjo rinia ka filluar me fustana, pantollona, bluza, domethënë kështu. E gratë e moshuara i kanë pasur këmishat e veçanta të cilat i kanë endur, boshqet të cilat i kanë bërë në vek dhe kështu, kjo ka qenë.

Anita Susuri: Ju këtu keni shkuar në shkollë, në Janjevë? Në “Vlladimir Nazor”?

Nikolla Brkiq: Po.

Anita Susuri: A ka qenë atëherë shkollë e re e sapohapur apo?

Nikolla Brkiq: Jo, atëherë ka qenë shkolla e vjetër dhe aty kemi qenë 1160 nxënës kur kam shkuar unë. Dhe aty nuk ka pasur mjaft vend, pastaj kemi shkuar edhe te posta ka qenë një ndërtesë ndihmëse dhe përfundi shkollës edhe një ndërtesë, shtëpia e blerë ka qenë aty. Aq paralele ka pasur, domethënë, nxënës ka pasur [shumë]. Prishtina nuk ka pasur aq, Lipjani nuk ka pasur aq nxënës sa ka pasur Janjeva.

Anita Susuri: A mund të na flisni pak më shumë për këtë periudhën e jetës suaj?

Nikolla Brkiq: Kur kemi shkuar në shkollë domethënë ka pasur shumë fëmijë. Edhe kushtet kanë qenë shumë të rënda, ka qenë ngrohja me dru nganjëherë bënin tym ato oxhaqet, pastaj uji ka qenë problem. Ujë nuk ka pasur në shkollë domethënë, shkolla e vjetër e ku ta di. Mësonim, jemi shkolluar mirë domethënë, ne kur e përfundonim shkollën më shumë shkonim në zanatin tregtar. Këtë e kemi dashur domethënë, ajo na ka ngrehur. Tani shumica po e përfundojnë shkollën pastaj fillojnë punë me tregti.

Anita Susuri: A ka qenë paralelja juaj te posta apo ku ka qenë paralelja juaj atëherë?

Nikolla Brkiq: Po deri të katërtën, deri në klasën e katërt kemi qenë te posta. Aty ka qenë një shtëpi e vjetër domethënë, aty kemi qenë me diku katër-pesë klasë, një sallë e vogël ka qenë aty. E këtu sipër ka qenë shkolla e madhe, pastaj në klasën e pestë, lart kemi shkuar në shkollën e madhe.

Anita Susuri: Dhe si ju është dukur atëherë, kur keni shkuar do të thotë nga ajo klasa e vogël në atë shkollë?

Nikolla Brkiq: Po aty të gjithë ne fëmijët kemi qenë, të gjithë fëmijët kemi qenë aty dhe të gjithë jemi shoqëruar, shiheshim për çdo ditë dhe kështu. Pastaj nuk ka pasur, nuk ka pasur shumë dallime, domethënë sa i përket asaj.

Anita Susuri: (kollitet) Domethënë kur keni qenë atëherë në shkollë, a ka qenë edhe atëherë i hapur, e hapur Shtëpia e Kulturës? Apo biblioteka këtu tek posta?

Nikolla Brkiq: Ka qenë biblioteka te posta, aty merrnim libra, lektyra, mësonim, lexonim dhe i kthenim. Kjo ka qenë aty, biblioteka ka qenë aty. Shtëpia e Kulturës ka qenë aty, një sallë ka qenë aty,

aty janë mbajtur ballot në atë kohë. Kinemaja ka qenë fillimisht domethënë, shikoheshin filmat e të dielën aty ka qenë balloja. Domethënë, aty shoqëroheshin djemtë, vajzat, aty njiheshin, aty vallzonin, hedhnin valle, ajo kjo. Prej aty të shumë janë martuar, domethënë kanë ikur (qesh) dhe kështu ka qenë.

Anita Susuri: Çfarë muzikë dëgjohej aty, çfarë muzike lëshonin?

Nikolla Brkiq: Po dëgjohej, atëherë në ish Jugosllavi askush nuk shikonte çfarë muzike është, a është boshnjake, a maqedonase, a është kroate, domethënë askush nuk ka menduar për këtë. Me rëndësi ka qenë vetëm të jetë e mirë, muzikë e hareshme, domethënë të jetë këngëtar i mirë. Atëherë ka qenë Safet Isoviq, ka pasur shumë, Shaban Shaulliq domethënë ka pasur edhe shumë. Zorica Brunclik, domethënë ka pasur edhe shumë këngëtarë me të cilët jemi kënaqur edhe kaseta për veturë blenim. Shkonim në Prishtinë për të blerë kaseta, ka dalë kaseta e re (qesh), ne shkonim me autobus në Prishtinë e nuk gjenim kaseta ktheheshim, shkonim tjetër herë i gjenim dhe i blenim.

Anita Susuri: E për, kur kanë qenë ato ballot, a kanë kënduar drejtëpërdrejt, ndonjë orkestër diçka të tillë a ka pasur?

Nikolla Brkiq: Ka pasur, ka qenë grupi ynë janjevas, “Rinia”. “Rinia” ka bërë muzikë, ata janë tani në Kroaci. Domethënë edhe këndonin edhe kaseta lëshonim. Dikur kanë pasur tingull të madh kasetat, kur luanin valle gjithashtu lëshonin, bënë muzikë. Vallja e grave, pastaj sa-sa², pastaj të vjetra turke, pastaj domethënë këto janë të gjitha ato vallzimet që kanë qenë.

Anita Susuri: A ju kujtohet edhe ndonjë detaj nga Kino Salla, për shembull çfarë filma ka pasur, çka kanë lëshuar? A keni shkuar ju?

Nikolla Brkiq: Po kemi shkuar por aty kanë qenë domethënë, filma kështu normal. Filma me kauboj që kanë qenë në atë kohë që kanë qenë ata filmat dua të them. Kështu, domethënë ka qenë, filmat, në atë kohë filmat, nuk më kujtohet çfarë ka pasur...

Anita Susuri: A ju kujtohet hera e parë kur keni shkuar ta shikoni një film në Kino Sallë?

Nikolla Brkiq: Po, më kujtohet atëherë domethënë nuk ka mundur gjithkush të hyj aty, aty ka pasur shumë turmë. Populli ka numëruar pesë mijë njerëz domethënë e salla ka qenë e vogël. Dhe tani kush është më i madh, kush është më i fortë, ai gjithmonë te dera, e merr biletën në sportel dhe e zënë një vend atje pastaj thonë, “Nuk ka më vend” dhe nuk mund të vish në sallë të shikosh.

² Lloj i vallzimit tradicional, valle.

Anita Susuri: A mund të më tregoni për kohën kur ju keni filluar të dilni këtu në Janjevë? Pasi që ka pasur mjaft jetë edhe kështu domethënë, ka pasur mjaft kafene dhe restaurante, prandaj Janjeva ka qenë...

Nikolla Brkiq: Janjeva ka qenë, i ka pasur tetë kafene.

Anita Susuri: Po.

Nikolla Brkiq: Dhe kanë qenë gjithmonë të mbushura. Domethënë aty vinin edhe nga rrethi, nga Prishtina, edhe nga Fushë Kosova, nga Gushterica, nga Ferizaji, Lipjani njerëzit vinin këtu. Dhe e kemi pasur brendin tonë, suxhukun janjevas, qebapat janjevase, mishin. I kemi pasur tetë mishtore. Dhe ato mishtoret gjithmonë kanë pasur grill. Dhe ato kur i vendosnin, kur i vendosnin në qymyr, jo në rrymë por në qymyr, as në plin jo, në qymyr. Dhe ajo kur, kur kalon njëqind metra prej asaj mishtores, 50 metra, aty është e gjithë qendra, aty ku ka qenë e gjithë çarshia si e thërrasim ne, aty vinte era e suxhukut, e qebapave dhe e mishit.

Anita Susuri: A mund të ma përshkruani pak qytetin në atë kohë? Si është dukur?

Nikolla Brkiq: Po Janjeva ka qenë e vjetër, pas '80 e diçka, vitit '70 e diçka kanë filluar ndërtimet, shtëpitë e reja, ka qenë ngushtë. Atëherë janë shembur ato shtëpitë e vjetra, gërmonin me kazma, me lopatë janë ngarkuar disa traktorë, hidhej ai dheu që të rregullohet ai vendi për shtëpinë. Ai vend ka qenë gjithmonë i ngushtë, sepse shtëpia ishte afër shtëpisë tjetër, vetëm gjysmë metër, një metër, nuk kishte më shumë largësi prej njëra-tjetrës. Është vendi që ndoshta në botë ka qenë më i populluari. Dhe shtëpitë kanë qenë të shtrenjta këtu, kurrë nuk ke mundur të blesh shtëpi. Ke mundur në Prishtinë t'i blesh dy shtëpi ose në Nju Jork apo në Kanada ta shesësh këtu shtëpinë e ta blesh atje. Sepse shtëpia në shitje nuk ka pasur në atë kohë.

Rrallë herë shitej, kur filluan të shpërngulen për Zagreb, '78, '80-tën dikush, gjithmonë, ai shpërngulet vjen tjetri menjëherë e blen shtëpinë, dua të them tjetri e blen shtëpinë dhe menjëherë fillon të jetoj aty. Parking nuk ke mundur të gjesh më herët në Janjevë. Kështu ka qenë, shumë popull dhe të gjithë, feja na ka obliguar të jemi këtu, në këtë vend dhe këtë e kemi pasur. Kemi pasur edhe tokë poshtë, domethënë në drejtim të "Metalikut", kah Sushica, aty ta ndërtojmë por aty, kështu kemi qenë në atë kohë. Të gjithë afër aty, ngushtë kemi qenë. Domethënë ashtu kemi... vetëm të qëndrojmë në gjirin e Janjevës, në këto kodra.

Anita Susuri: Në Janjevë ka mjaft shtëpi të vjetra edhe e juaja është njëra prej tyre. A ka, a ka ndryshuar ndonjë gjë apo ka mbetur autentike, do të thotë sa i përket shtëpisë, shtëpisë tuaj?

Nikolla Brkiq: Gjyshi im kur e ka blerë, domethënë në këtë rrugë kur erdhi këtu, ai e ka blerë të vogël, shtëpia e vockël ka qenë. Dhe aty, gjysma ka qenë shtëpi, gjysma ka qenë hangar. Ka qenë e vogël, ka

qenë ndoshta pesë me, katër me gjashtë [metër] apo katër me shtatë, domethënë kështu ka qenë, kështu ka qenë në atë kohë. Pastaj kjo shtëpia u ndërtua në vitin 1951, kur ka qenë uria më e madhe në ish-Jugosllavi domethënë ka pasur thatësira. Atëherë njerëzit punonin për dy kilogram të miellit të misrit, në mënyrë që ta ushqenin familjen. Rrëmonin gjithë ditën, ose për miellin e bardhë të grurit ose për miell të misrit. Atëherë ndërtohej kjo shtëpi dhe në këtë rrugë ka qenë shtëpia më e madhe. Gjyshi im, domethënë babai dhe xhaxhallarët, kanë gërmuar, kodrën e kanë rrafshuar në mënyrë që ta ndërtojnë [shtëpinë]. Kjo shtëpia e ka murin gjysmë metër [të gjërë], pjesa e parë është e tëra me gurë dhe e dyta është me çerpiq siç themi ne, prej balte, prej tulle.

Anita Susuri: Dhe prej atëherë ju ende jetoni...?

Nikolla Brkic: Po. Domethënë ne jetojmë këtu, atëherë vëllezërit janë shpërngulur, motrat janë martuar dhe janë shpërngulur. Tani kemi mbetur ne. Babai ka vdekur, ne jemi kthyer këtu, me gruan dhe dy fëmijë. Tani i kemi katër fëmijë, edhe dy janë lindur. I vetmi kroat i kthyer në Janjevë.

Anita Susuri: Do të thotë ju keni qenë jashtë dhe jeni kthyer?

Nikolla Brkic: Në Kroaci. Po. Babai ka qenë i sëmurë atëherë nuk ka mundur askush, nuk e kemi lënë babain vetëm dhe kështu jemi kthyer. Tani ja po jetojmë kështu.

Anita Susuri: Mirë, do të flasim edhe për këtë. Por desha t'ju pyes më shumë për çarshinë. Do të thotë është aty kafeneja Bash Çarshia, pastaj është edhe një lokal, 1928.

Nikolla Brkic: Po.

Anita Susuri: Çka ka pasur atëherë në ato kafene? A ka qenë kafene?

Nikolla Brkic: Kafenetë janë hapur, pastaj ajo kafene është hapur më vonë. Të parët tonë kanë pasur rreth 300 hektarë të vreshtave të rrushit. Ne themi se ato janë gërmuar me dorë, rrëhim është thënë atëherë, e dini thoshin të rrëmosh. Duhej të gërmosh së paku gjysmë metër thellësi që ta mbjellësh hardhinë. Dhe në vitin e tretë vinte hardhia. E në ndërkohë, aty është vendosur qepa. Ne i themi karamid, qepa është mbjellur aty, do të thotë për të mbirë hardhia. Dhe tani, po bjen fjala kishte edhe bodrume të rakisë dhe verërave. Bodrumet e njohura. Rahoveci pastaj është ndërtuar. Në këto kodrat tona kanë qenë romakët.

Ata kanë pasur vreshta pastaj ashtu, është bërë shkretëtirë kur janë tërhequr ata. Tonët kanë ardhur dhe kanë filluar propë gërmimin. Mendoj kanë gërmuar kanë mbjellur hardhi, hardhi. Kemi pasur rrush të zi, të bardhë, hamburg. I kemi pasur të gjitha llojet e rrushit që ekzistonin në ish-Jugosllavi. Dhe të gjitha llojet e qershive i kemi pasur, kajsia, molla, dardha. Dhe tonët kanë qenë atëherë që themi ne

tregtarë shëtitës. Ashtu i quanim ne *skitači*³. Dhe ata kudo që shkonin në Maqedoni apo në Slloveni apo në Kroaci, Bosnje, ku do që shihnin ndonjë pemë e merrnin fidanin dhe e vendosnin në patate që të mos thahet, dhe kur vinin i shartonin. Dhe nuk ka pemë që nuk ka pasur kjo tokë e Janjevës.

Anita Susuri: A i ka pasur edhe familja juaj ato...

Nikolla Brkiq: Vreshtat?

Anita Susuri: Vreshtat dhe... ?

Nikolla Brkiq: Xhaxhai e ka pasur një hektar me vreshta. Ai e ka blerë diku rreth vitit '78 e gjyshi ynë, stërgjyshi domethënë, ne kemi pasur vreshta, 38 ari vreshta. E ne kur e kemi blerë vreshtën, këtu nuk ka pasur tokë për tu blerë, ka qenë kodër. Pastaj është pastruar, ato gjembat, barërat dhe kanë gërmuar gjysmë metri, dhe kanë mbjellur. Kemi pasur vreshta, kemi pasur *praske*, ne ju themi pjeshkave *praske*, qershia, dardha të ndryshme, molla.

Por kur e ka blerë gjyshi im atë vreshtën, atëherë kanë qenë dymbëdhjetë para të qeve në atë kohë. Dhe plus një vol tek për atë vreshtën. Pastaj, ata në vitin '34 kanë gërmuar, kanë gërmuar deri në vitin 2003. Në vitin 2003 dikush na e ka djegur vreshtën. Ka qenë një vreshtë në kodër, është djegur pastaj e kemi rinovuar. Pastaj fatkeqësisht, nuk kishte askush vreshtë, fëmijët, të gjithë vinin, merrnin dhe më e kemi lënë.

Anita Susuri: A i keni pasur edhe ju ato bodrumet ku e keni ruajtur rakinë dhe... ?

Nikolla Brkiq: Po. Ne kemi, ne kemi mbajtur për vete dhe diçka pak kemi shitur. Vera pastaj hargjohej, atëherë nuk ka pasur birrë, rakia e shtëpisë dhe vera e shtëpisë. Ajo ka qenë edhe për Krishtlindje edhe për festa edhe për të gjitha. Edhe kur shkon te miku në festë dhe kështu, kur shkohej për ditën e emrit në Janjevë, domethënë ashtu çonin. Një kilogram raki, verë, kështu ka qenë kjo.

Anita Susuri: A kanë blerë edhe të tjerët prej vendeve të tjera apo vetëm këtu në Janjevë?

Nikolla Brkiq: Jo, vinin nga Prishtina vinin, nga këto fshatrat në afërsi të Janjevës, të gjitha që janë Sushica, Gushterica, ajo-kjo. Domethënë, secili ka ardhur shishe me verë të blej edhe për festë edhe për Krishtlindje. Plus, ata vinin blenin plus këtu pinim. Kafenetë nuk kanë qenë, kanë qenë bodrumet. Dy-tri bodrume kanë qenë, fuçitë kanë qenë të mbushura përplot për shkak se njerëzit kanë pasur shumë vreshta, nga pesë-gjashtë hektarë vreshta dhe aty bëhej vera dhe derdhej në ato bodrume. Kanë pasur stola, për rakinë dhe verën. Aty mblidheshin nga anët tjera, nga fshatrat vinin në Janjevë. Vinin në treg, shëtiteshin njerëzit në atë kohë dhe aty pinin rakinë dhe verën.

³ *Skitači*, në zhargonin janjevas do të thotë tregtarë shëtitës.

Anita Susuri: A keni filluar herët të merreni me bujqësi apo me çka jeni marr fillimisht, do të thotë çfarë pune keni bërë?

Nikolla Brkiq: Që prej fëmijërisë, me babain domethënë si fëmijë kam punuar. Pastaj kemi qenë në Kroaci kemi punuar me bizhuteri, aksesuar prej lëkure në ish-Jugosllavi. Tre vite, pastaj ka filluar lufta dhe kemi mbetur, malli ka mbetur atje, shtandet kanë mbetur, ne kemi mbetur këtu. Babai thoshte, “Ruaje kokën, lëri paratë dhe mallin”. Dhe kështu ka qenë. Shumë njerëz kanë pësuar, shumë dyqane janë djegur... luftë.

Anita Susuri: Me sa vjet keni shkuar atje domethënë të merreni me bizhuteri?

Nikolla Brkiq: Po me dhëndërrin, atëherë kam shkuar 1988-tën, ‘87-tën kam qenë në Zagreb e ‘88-tën pastaj kam shkuar të punoj në Vodice, pastaj në Primoshten.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Na flisni pak më shumë për atë punën tuaj.

Nikolla Brkiq: Po atëherë kemi filluar domethënë, të gjithë janjevasit kanë filluar përnjëherë. Në deti hapeshin shtandet dhe unë kam shkuar pas dhëndërrit. Dhëndërrin punonte në Split dhe atëherë kemi shkuar, e kemi marr një vend, mallin e kemi marr në Zagreb dhe atëherë kemi filluar me atë bizhuterinë, aksesoret e lëkurës, programi detar, domethënë syze, papuçe dhe kështu, rripa, kuleta për femra, për meshkuj domethënë. Ka qenë atëherë edhe bizhuteria dhe kështu.

Anita Susuri: A i keni marr ato prej këtu, domethënë prej Janjevës apo ka ardhur malli kinez pastaj? Si ka qenë kjo?

Nikolla Brkiq: Diçka është prodhuar në Janjevë, diçka është prodhuar në Zagreb dhe kështu është përshtatur tregu. Të gjitha produktet që janë prodhuar në Zagreb, kanë ardhur në Janjevë. Në Janjevë çka është punuar, është dërguar për Zagreb dhe kështu ka qenë malli, asortimentin ke mundur ta bësh si të duash. Malli kinez ka ardhur diku në vitet e ‘90-ta diku. Domethënë, malli italian diçka, pastaj malli kinez ka ardhur tani, ka ardhur vonë. Përndryshe, ne e kemi pasur prodhimin tonë në Janjevë. Edhe kapëse edhe skitë për fëmijë, domethënë ka qenë bizhuteria. Kjo është prodhuar prej teli të thjeshtë, është derdhur plastika, legena, korita. Po mendoj në Pazovë i kanë punuar legenat, bokallat, ajo-kjo domethënë. Janë punuar këto, shumë gjëra janë punuar në Janjevë. Kamionët, veturat, traktorët [lodra të plastikës] domethënë, dua të them që në atë kohë këto kanë shkuar. Domethënë malli kinez ka ardhur vonë.

Anita Susuri: A i keni bërë këto ju apo i keni marrur nga janjevasit këtu?

Nikolla Brkiq: Po prej janjevasve. Unë kam prodhuar për shembull veturë, ti ke prodhuar ndonjë kamionetë, ky e ka prodhuar kapësen, ky diçka tjetër, domethënë e gjithë kjo ka ardhur me të madhe. Dhe aty ke pasur asortiment, merrje aty.

Anita Susuri: Domethënë ju keni shkuar në Kroaci dhe keni punuar ashtu? Sa, sa vite ka vazhduar kjo?

Nikolla Brkiq: Po. Tri vite kemi punuar, pastaj ka shpërthyer lufta dhe... kështu domethënë.

Anita Susuri: Keni mbetur atje apo jeni kthyer?

Nikolla Brkiq: Jemi kthyer këtu. Pastaj ka qenë viti '92-'93 njerëzit kanë pasur lokale atje, atëherë shpërngulja ka filluar përnjëherë, disa kanë pasur lokale, disa kanë pasur shtëpia atje. Dhe kështu, atëherë nuk ka pasur punë fare. Dhe njerëzit ashtu janë tërhequr, familjet. Përndryshe, ata janë të parët tonë, domethënë kanë shkuar gjatë sezonës atje, tre muaj, tre-katër muaj kanë punuar pastaj gjithë dimrin vinin dhe jetonin në Janjevë.

Anita Susuri: Desha t'ju pyes tani për, si të them, dashurinë. Kur jeni martuar me gruan tuaj, si jeni takuar me të, ku keni dalur?

Nikolla Brkiq: Po te ne ka qenë (qesh) specifike. Këtu ka qenë qendra, kafenetë, kisha, kemi pasur meshë të veçantë, në mbrëmje ka qenë ajo, më shumë të rinjtë kanë shkuar. Dhe kështu, gjithmonë ashtu takohesh, ajo-kjo domethënë dhe e pyet a dëshiron të del dhe kështu njihesh. Pastaj pak ka qenë tek ne edhe të moshuarit, halla ajo-kjo, ky fëmijë është i mirë, i shtëpisë, nuk pi, nuk pi duhan, nuk shkon nëpër kafene, nuk është ndonjë siç thonë matrapaz, thoshin ashtu në atë kohë, tani thonë mangup, (qesh) në atë kohë thoshin matrapaz. Dhe kështu ka qenë domethënë, martesë dhe dasma. Dhe më së paku shkurorëzime ka pasur në Janjevë, ndoshta edhe në botë. I tillë ka qenë vendi domethënë.

Anita Susuri: Çfarë tradita kanë qenë për shembull për fejesë, për martesë, tuajat, të familjes tuaj?

Nikolla Brkiq: Po, së pari kur ne domethënë, kur janë martuar për shembull motrat, ata vinin dhe e sjellnin një shenjë, e dërgonim një peshqir. Ata vinin dhe ne pastaj dërgonim dhe kur vinin ata përgadisim paragjellë, meze quhet ajo, kështu e quanim, mish, djathra, ajo-kjo, tortet, pijet. Dhe ata vinin aty, pastaj puthej dora, dua të them, nusja dilte pas një orë e gjysmë, nusja e veshur pastaj ata ja jepin unazën. Dhe ajo, pija kështu shkonte. Pastaj ka qenë biseda, kështu thuhet, pastaj mbledheshin gratë, ajo quhej *boja*, dhuratat, një javë para dasmës.

Të enjten mblidheshin gratë, dërgonin dhurata atëherë. Në atë kohë dërgonim domethënë edhe jastekë, jorgan, batanije “Ambasador”, disa gjëra domethënë veshje, diçka e tillë atëherë mblidhej dhe dërgohej si dhuratë nga ana e grave. Të dielën pastaj ka qenë dasma. Domethënë, fillonte prej 8:30 te dhëndërri. Pastaj në kishë në ora 11:00 kurorëzimi, vajza kthehej me familjen e vet në shtëpinë e saj, këta kanë festuar domethënë tek dhëndërri, atje familja e tij. Vinin, pastaj vinin në 14:30, e merrnin nusen, dhe e sjellnin me vete.

Anita Susuri: Si ka qenë ajo ditë për juve, kur jeni martuar me gruan tuaj?

Nikolla Brkiq: Ne nuk e kemi bërë dasmën këtu, ne këtu e kemi bërë vetëm një kurorëzim. Në atë kohë po mendoj, sepse babai pat vdekur mendoj, dhe mendoj që kemi bërë vetëm kurorëzim.

Anita Susuri: Në cilin vit jeni martuar ju?

Nikolla Brkiq: 1993.

Anita Susuri: Kur keni filluar të merreni me bujqësi, a mund të më flisni pak më shumë për këtë? Kur keni filluar, çka keni punuar, si ju ka shkuar puna?

Nikolla Brkiq: Po puna ka shkuar deri, deri në kohën e embargos mirë, çmimet kanë qenë stabile dhe kanë qenë çmimet e larta për grurin. Vlera ka qenë gruri dhe misri dhe bagëtia domethënë në atë kohë ka qenë e mirë. Pastaj kur ka hyrë, kur ka qenë embargo në ish [Jugosllavinë], dua të them Republikën Federale të Jugosllavisë, atëherë çdo gjë ka filluar të shkoj shtrembër dhe nuk kemi mundur, nuk ke mundur as mekanizmin nuk ke mundur ta blesh, as atë, as këtë. Domethënë, e gjithë ajo, vitet e fundit import i madh dhe po shkojnë të gjitha. Përndryshe, ne e kemi bërë një oazë, nëse mund të them, atje te “Metaliku” i kemi 600 copë pemë, serra, i kemi tetë bunarë, 100 dhe 500 metër i kemi bërë, aty kemi menduar të jetojmë. T’i ndërtojmë tokat, shtëpitë, pushimoret, por ka ardhur koha të ikim. Kështu mendoj, për shkak të punës {merr shishen me ujë}.

Anita Susuri: Kur ka qenë domethënë, kur ka shkuar më së miri puna, në cilën kohë?

Nikolla Brkiq: {pi ujë} Po në vitin ‘86 ka qenë, ka qenë më e mira dua të them. Në vitin ‘86 një kilogram i farave të luledielli ka qenë një euro, gjashtë tonë fara luledielli në atë kohë ke mundur Lladën⁴ e re ta blesh apo Zastavën⁵ e re, me gjashtë tonë. Pasuli ka qenë dy marka, karburantet kanë qenë përmes kooperativës, lirë dua të them, plehrat kanë qenë, dy kilogram pleh për një kilogram grurë. Tani për shembull dy kilogram grurë për një kilogram pleh dhe kështu. Atëherë ka qenë më së miri. Kurse tani është gjithnjë e më vështirë.

⁴ Llada është një markë e makinave të prodhuara nga AvtoVAZ, dhe një kompani ruse në pronësi të Groupe Renault.

⁵ Zastava 101 është prodhues i makinave i vendosur në Kragujevac, Serbi, i cili bëri makina të bazuara në Fiat për tregun e Evropës Lindore. Kompania u bë një degë e Fiat Chrysler Automobile 2014.

Anita Susuri: A mund të na flisni pak për daljet në çarshi për shembull? A keni shkuar ju në çarshi, si ka qenë, si ka qenë atmosfera?

Nikolla Brkiq: Po si fëmijë dua të them kur kemi dalur, Janjeva ka qenë përplot domethënë. Dhe gjithmonë kemi shkuar, i kemi pasur ëmbëltoreset aty. Gjithmonë kemi shkuar të blejmë akullore si fëmijë. Kur shkonim në kishë, kur ktheheshim, gjyshja na jepte para apo babai, nëna dhe blenim akullore. Në atë kohë ka pasur njëfarë hallve të bardhë, zhabica, indijanka, sutliash, pastaj tullumbat. Kjo ka qenë aty. E nëpër kafene kanë shkuar njerëzit e moshuar, po mendoj edhe kështu, rinia ka shkuar më shumë. Rinia ka shkuar nëpër kafene për punë, kurse kjo rinia nëpër kafiteri. I kemi pasur tetë kafiteri në Janjevë. Në kafene i pari, i pari aparat për kafe në Kosovë ka ardhur këtu, në kafenenë tonë në Janjevë. Në atë kohë "Grand Hotel" nuk ka pasur aparat për kafe. Prej Italisë atëherë, një njeri i joni e ka sjellë aparatën për kafe. Aparati i parë në Kosovë.

Anita Susuri: Çka ju kujtohet ende prej asaj çarshisë?

Nikolla Brkiq: Ka pasur gjëra të bukura. Ka pasur shoqërime, shkonim, pinim, bisedonim, bënim shaka, kalonte koha. Dikur i merrnim sajat si të ri. Merrnim një shishe verë, pesë kilogram, i merrnim sajat dhjetë veta ishim shkonim lart në maje të Janjevës dhe lëshoheshim deri te qendra e Janjevës me sajë. Bukur, bukur, bukur ka qenë domethënë.

Anita Susuri: Keni pasur edhe mashkare, si maskenball. Si ka qenë ajo?

Nikolla Brkiq: Mashkare, ajo është, i bie pesë javë para Pashkëve. Ne i themi karnivale, është dita e parë e Kreshmës. Aty ka pasur veshje të ndryshme, meshkujt visheshin si femrat, e femrat si meshkujt. Veshje të ndryshme dimija, kostume të vjetra, kostume të reja. Po mendoj ashtu, makiazhe të ndryshme, ngacmime, po mendoj meshkujt, që të mos mund ta njohësh. Edhe sot ka, por vetëm fëmijët aty pak. Përndryshe, më herët ka pasur edhe gara. Pastaj ka qenë ajo shkonim te Kino Salla në mbrëmje ashtu të maskuar. Pastaj në atë kohë ka qenë vendi i parë kush, kush e ka fituar vendin e parë. Ka pasur, ka pasur shpërblim ca para.

Anita Susuri: A je maskuar edhe ti?

Nikolla Brkiq: Po jemi maskuar si jo.

Anita Susuri: Si jeni dukur?

Nikolla Brkiq: Gjithçka. Gjithçka kemi veshur, gjithçka. Dimija. Ka pasur njëri aty qerre me kuaj, qerre me kuaj, ato të drurit. Pastaj nëpër Janjevë, pastaj ajo daullja, disa kitare të vogla, të maskuar. Ajo ka

qenë shëtitje nëpër gjithë Janjevën. Në atë kohë si fëmijë e kujtoj, po mendoj edhe ashtu si djalosh, me 16-17 vjet. Ka qenë përplot.

Anita Susuri: Ju më keni folur për Letnicën. E di që disa shkonin dhe qëndronin nga një muaj atje në Letnicë. A keni shkuar kështu edhe ju dhe familja juaj?

Nikolla Brkiq: Ne për shkak se kemi pasur tokë dhe bagëti kemi shkuar atë ditë, për Zonjën e Vogël dhe Zonjën e Madhe. E më herët në Janjevë shkohej pesëmbëdhjetë ditë para. Njerëzit nuk shkonin në deti, nuk shkonin ashtu, shkonin në Letnicë, në vendin e shenjtë, Zagragje i themi ne. Dhe aty vendosnin cerada, mbulesa për mure, dua të them çilimat në atë kohë. Nuk kemi pasur tepiha, por çilima. Aty gatuanin, përgadisnin, shkonin ato pesëmbëdhjetë ditë në kishë për meshë dhe ka qenë ajo tradita. Edhe sot ka diçka të tillë por më pak. Vijnë edhe nga Zagrebi mjaft, e për Zonjën e Vogël vijnë nga Kroacia atëherë nuk e kanë më sezonën dhe vijnë.

Anita Susuri: E keni përmendur atë sezonën. A kanë punuar janjevasit gjithmonë në sezonë?

Nikolla Brkiq: Paj sezona në deti fillon, më herët ka filluar prej muajit qershor, tani dikush shkon edhe në muajin maj, deri 01. 10. E dikush jeton ku janë qytetet e mëdha, po mendoj në bregdet. Ata jetojnë aty dhe jetojnë gjatë gjithë vitit. Përndryshe, sezona vjen, po them prej 10-15 majit fillon pastaj deri 01.10 dhe 01.09 si është vendi në bregdet.

Anita Susuri: A e mbani në mend apo a ju kujtohet si ka filluar situata të ndryshoj këtu në Janjevë? Do të thotë, të shkoj kah e keqja, te bëhet...

Nikolla Brkiq: Po situata në ish-Jugosllavi, kur është, atëherë ish-Jugosllavia i ka vendosur kufinj, kur ka shpërthyer lufta në Kroaci, në Bosnje domethënë atëherë njerëzit është dashur... Ato para që i kanë pasur i kanë ngrënë këtu, i kanë shpenzuar dhe është dashur të shkojnë. Pastaj e kanë marrur familjen e tyre dhe kanë shkuar në Kroaci. E dyta, pastaj këtu ka qenë embargo, njerëzit, inflacion i madh. Njerëzit është dashur me dy marka, pension pesë marka, prej rrogës nuk kanë mundur të mbijetojnë, nuk kanë pasur as tokë, nuk kanë pasur bagëti pastaj kanë filluar.

Lart ka qenë jeta më e mirë, njerëzit me halle shkonin, kanë shkuar të gjithë të jetojnë me qera, në livadhe kanë shkuar. Dua të them, tani të gjithë falë Zotit janë rregulluar, kanë punuar, i kanë ndërtuar shtëpitë atje, i kanë blerë tokat jashtë Zagrebit, dua të them në lagje ku kanë qenë ato livadhet. I kanë ndërtuar shtëpitë, tani jetojnë mirë por atëherë ka qenë në një shtëpi 30-40 njerëz. Në një banjo të shkojnë, ka qenë katastrofë domethënë. Pa punë, fëmijët i merr pesë-gjashtë fëmijë në një botë të huaj i dërgon. Po themi botë e huaj, ai është shteti jonë tani po mendoj (qesh) ka qenë edhe ish-Jugosllavia e jona, ne kemi pasur... ka qenë e vështirë, e vështirë ka qenë.

Anita Susuri: Këtu ka qenë edhe Shesheli mendoj. Si ka, a keni qenë ju këtu kur ka ardhur ai?

Nikolla Brkiq: Po Shesheli kur ka qenë, ai askujt nuk i ka bërë gjë, askend nuk e ka vrarë, askujt nuk i ka thënë asgjë dua të them, ka ardhur, ka shëtitur, ka qenë dhe ka shkuar.

Anita Susuri: E a ka filluar prej atëherë, a kanë filluar njerëzit prej atëherë edhe më shumë të shkojnë apo si ka qenë?

Nikolla Brkiq: Më shumë për çështje ekonomike, më shumë ekonomike. Ata njerëzit që kanë pasur dyqane atje, që kanë prodhuar, që kanë jetuar atje gjatë sezonës dhe kanë fituar atje, ata kanë ardhur këtu, me familjen i kanë shpenzuar ato paratë këtu. Edhe që kanë punuar në Beograd, në Sarajevë, në Bosnje domethënë ku kanë punuar, në Malin e Zi, në sezonë. Kanë punuar gjatë sezonës dhe ata vinin këtu, gjithmonë ajo paraja është shpenzuar këtu dhe tek të gjithë që jetojnë në këtë vend, në këto fshatra. Për qumësht, për derr, dele, atë-këtë, të gjitha, pasul, të gjitha që kanë qenë të prodhuara në këtë pjesë të Kosovës këtu, të gjitha janë shitur.

Anita Susuri: A keni qenë ju i vetmi apo edhe dikush është kthyer nga Kroacia këtu?

Nikolla Brkiq: Askush nuk është kthyer. Unë jam i vetmi.

Anita Susuri: E pse jeni kthyer ju?

Nikolla Brkiq: Paj, atëherë babai ka qenë i moshuar, i sëmurë dhe vëllau është martuar. Ai nuk ka mundur të punoj në bujqësi, nuk e ka bërë kurrë këtë punë domethënë. Dhe ai është shpërngulur për në Kroaci, pastaj babai nuk ka dashur ta lëshoj vatrën domethënë këtu dhe kështu unë jam kthyer dhe kemi mbetur të jetojmë këtu.

Anita Susuri: Dhe si kanë qenë ato vite për juve? Domethënë vitet e '90-ta deri '99-tën domethënë kur ka filluar lufta. Si ka qenë këtu?

Nikolla Brkiq: Po jetohej ashtu, populli shkonte, më shumë e më shumë shpërngulej. Kur shpërngulet populli çdo vit pak e më pak. Pak e më pak punë domethënë, shitje dhe kështu.

Anita Susuri: A ka shkuar dikush prej rrethit tuaj dhe si e keni, si e keni, si ka qenë për juve? A ka qenë e vështirë apo?

Nikolla Brkiq: Po kur është shpërngulur daja, dy dajë kanë shkuar me familje. Kur kaloja rreth shtëpisë së tyre, e shikon, sikur të ishin aty, sikur do të shkosh për kafe, do të shkosh për festë, do të shkosh për ditën e emrit. Kjo ka qenë domethënë pikëlluese. E sheh shtëpinë si po rrënohet, po rrjedh shiu, pastaj dikush e bastis shtëpinë. E vështirë është, shikon se si janë rritur barërat. Të vështira janë këto gjëra dhe vet jeta këtu.

Anita Susuri: E si ka qenë gjatë luftës?

Nikolla Brkiq: Po në kohën e luftës unë jam shpërngulur. Motra më është martuar më 23 në vitin '98 e kemi marr vizën dhe jemi nisur për Kroaci në dasmë. Pastaj ka filluar domethënë ajo, ka filluar lufta, krismat ajo-kjo. Babai tha, "Qëndroni atje". Babai ka qenë vet këtu, kemi pasur pak bagëti. Ai pastaj aty qëndroi, [situata] u qetësua pak. Kemi ardhur në pranverë, pastaj kanë shpërthyer bombardimet në mars aty kemi qenë gjatë bombardimeve.

Anita Susuri: A jeni frikësuar? Si ka qenë për juve?

Nikolla Brkiq: Po, si jo (qesh). Kur kemi, kur kanë rënë ato raketat e para, aeroplanët. Ka qenë e vështirë, e tmerrshme. E tmerrshme ka qenë.

Anita Susuri: A ka ndryshuar diçka për juve pas luftës?

Nikolla Brkiq: Në Janjevë po mendon?

Anita Susuri: Po për juve personalisht për shembull.

Nikolla Brkiq: Paj asgjë, kemi mbetur të papunë. Aty me bujqësi, kemi kërkuar disa ndihma prej Ministrisë së Bujqësisë, e kemi kërkuar mini farmën, nuk e kemi fituar. E kemi kërkuar një mekanizëm, nuk e fituam. Dhe me këto tonat, atë traktorin që e kemi 40 vite dhe atë mekanizmin e vjetër që e kemi. Me ato punojmë, po luftojmë të mbijetojmë.

Anita Susuri: Më flisni pak për atë se si jetoni tani domethënë, çka punoni, diçka për punën tuaj.

Nikolla Brkiq: Po tani çka kemi, ajo që ka mbetur është pronë e familjes. Aty pak po punojmë sa mundemi. Aty fitojmë pak gjatë sezonës, pak me domate, pak specat dhe këto domethënë. Ato i shesim aty te shtëpia në mënyrë që të blejmë dru, t'i arsimojmë fëmijët, gjëra dhe çka na nevojitet për shkollë, paisjet atë-këtë, ja këto.

Anita Susuri: Sa fëmijë i keni ju? Më flisni pak për fëmijët tuaj.

Nikolla Brkiq: (qesh) Po katër fëmijë i kam. Djali e ka përfunduar fakultetin për doganë, [shkollën] e lartë. Nuk ka pasur punë këtu, ky më i vogli njejtë, nuk ka pasur punë. Tani kanë shkuar në Kroaci. Vitin e kaluar kanë punuar gjatë sezonës, tani e kanë marr një banesë atje. Po e paguajnë banesën, punojnë shumë, pak paguhen dhe domethënë nuk ju mbetet gjë. Vetëm jetojnë atje, i kanë falë Zotit të dashur atje, tani do të martohet njëri ky më i vogli, tani do ta ketë fejesën. Dhe atje do të mbetet të jetoj.

Anita Susuri: Shumë bukur. A e kanë përfunduar ata këtu shkollën?

Nikolla Brkiq: Po, po, këtu. Këtu në Kosovë e kanë përfunduar shkollën dhe tani atje punojnë.

Anita Susuri: Domethënë ata nuk e kanë ndërmend të kthehen apo?

Nikolla Brkiq: Nuk kanë, çdo vit pesë-gjashtë prej tyre mbesin, rinia e Janjevës [mbesin] në Kroaci. Shkon për të punuar apo për tu martuar atje, e merr vajzën dhe askush nuk dëshiron të kthehet këtu. Nuk dëshiron të kthehet. Kushtet e jetesës janë shumë të këqija, nuk ka punë, asgjë nuk ka.

Anita Susuri: Si e keni tani në Janjevë? Si jetoni tani, si është në çarshi?

Nikolla Brkiq: Po çarshia mund të them që është çarshi e zbrazët. Aty janë disa njerëz që kanë mbetur, po mendoj ne, shqiptarët, turqit, dhe këta. Ata janë njerëzit e njejtë. Edhe vet shqiptarët po shpërngulen tani nga Janjeva, ata më shumë punojnë nëpër Prishtinë, nëpër dyqane, roje në depo, aty-këtu. Ata po shpërngulen për shkak të shkollës së mesme ata shkojnë në Lipjan në shkollë apo në Prishtinë. Po marrin banesa atje, atje po punojnë dhe pikërisht këtë vit diku dhjetë familje janë zhvendosur.

Anita Susuri: Si jetoni ju tani?

Nikolla Brkiq: Po ekonomikisht, shumë vështirë. Shumë vështirë... Ja shtëpia duhet të renovohet, nuk kemi mjete. Shumë vështirë.

Anita Susuri: A keni edhe diçka për fund të na thoni? Nëse diçka keni harruar apo dëshironi edhe diçka të na thoni?

Nikolla Brkiq: Po nuk ka çka, po mendoj (qesh).

Anita Susuri: Mirë atëherë, ju faleminderit shumë.

Nikolla Brkiq: Asgjë, ju faleminderit edhe juve.